

DIANA DJALOSHI

VËSHTRIM KONCEPTOLOGJIK I ANTONIMISË NË GJUHËN
SHQIPE

Problemet e terminologjisë shqipe qysh nga formimi i saj si nënsistem i mëvetësishëm leksikor në kuadrin e gjuhës letrare kombëtare e deri më sot në nivelin standardësor janë trajtuar në këndvështrimin gjuhësor, krahas mjaft çështjeve që u përkasin veçorive të shfaqjes së dukurive të terminologjive të fushave të ndryshme të dijes nga ana konceptologjike¹.

Për disa çështje themelore në mënyrë të veçantë për lidhjen e leksikut terminologjik me leksikun e përgjithshëm në rrafshin e veçorive të terminologjisë si leksik special, kanë dhënë ndihmesën e tyre A. Xhuvani, S. Riza, A. Kostallari, J. Thomai, M. Samara, Xh. Lloshi etj. Kështu, qysh në kohën e vet A. Xhuvani, ka prekur mjaft probleme të anës së trajtimit praktik dhe të zbatimit të termave në gjuhën shqipe², S. Riza³ka vështruar anën konceptore të termave të gramatikës, A. Kostallari dallimet e njësisve të leksikut në termat e jotermat⁴, J. Thomai ka trajtuar identitetin e termit në dallim nga fjala⁵ etj. Këndvështrimi gjuhësor, leksiko-semantik ka mbizotëruar edhe në anët e dukurive semantike të terminologjisë, siç janë sinonimia, polisemia, homonimia dhe antonimia.

Megjithatë, ndërmarrja e studimeve prej terminologëve tanë, duke filluar sidomos nga F. Leka⁶, H. Pasho⁷, A. Duro⁸, krahas gjuhëtarëve, kanë çuar në zbulimin e veçorive leksikore të dukurive semantike në terminologji, si mbizotërimi i termave dysorë në terminologji, të polisemisë e rrëgjuar në homonimi (Xhevat Lloshi⁹ etj.). Veçoritë e terminologjisë në fusha të ndryshme të dijes janë trajtuar deri në punime e artikuj si dhe në monografi të plota.

Duke mos u ndalur në probleme tashmë të njohura, që lidhen me shtrimin dhe zgjidhjen e mjaft problemeve që janë zbatuar edhe në praktikën

¹ V. Dervishi, *Termt e mekanikës në gjuhën shqipe dhe burimi i tyre konceptor*, Sf, 1991/1.

² A. Xhuvani, *Skanjet teknike, Vepra I*, Tiranë, 1980

³ S. Riza, *Kritika e gjuhës së gramatikës*, Vepra të zgjedhura, Tiranë, 2009

⁴ A. Kostallari, *Gjuha letrare kombëtare dhe epoka jonë*, SF, 1984/4.

⁵ J. Thomai, *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*, Tiranë 2009.

⁶ F. Leka, *Udhëzues për përpunimin e terminologjisë tekniko-shkencore*, Tiranë, 1983.

⁷ H. Pasho, *Terminologjia e ekonomisë në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009.

⁸ A. Duro, *Terminologjia si sistem*, Tiranë, 2001.

⁹ Xh. Lloshi, *Rreth disa shfaqjeve të homonimisë në gjuhën shqipe*, “Studime mbi leksikun”, Tiranë, 1972.

terminologjike (përpunimin e saj, pasqyrimin në fjalorë terminologjikë etj.) po nënvizojmë, për rastin e dhënë, se dukuria pak a shumë e vetme semantike në leksikon terminologjik që identifikohet nga ana e tipareve të përbashkëta me atë joterminologjike (me leksikon e përgjithshëm) është dukuria e antonimisë.

Siç dihet në rrafshin e leksikut tërësor të gjuhës shqipe, ku përfshihet edhe leksiku terminologjik, një studim i plotë monografik rreth çështjeve të antonimisë në gjuhën shqipe është kryer nga prof. Miço Samara¹⁰. Trajtimi i kësaj dukurie në monografi qysh në vitet 80-të përbën një përgjithësim thelbësor dhe ka gjetur zbatim pothuajse në të gjitha punimet shkencore terminologjike, ku është trajtuar edhe çështja e kësaj dukurie semantike, siç është antonimia edhe në terminologji. Kjo mund të thuhet pak a shumë për çdo punim për secilën fushë dije terminologjike të studiuar nga terminologët tanë si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë.

Qysh në fillim, duhet theksuar se në mbështetje të katër vetive kryesore, që vihen në bazë të identifikimit të çifteve antonimike, ku në themel qëndron këndvështrimi leksiko-semantik, mund të përligjet analogjia e dukurisë së antonimisë në të dyja llojet e leksikut, si për leksikon e përgjithshëm (joterminologjik) ashtu edhe për leksikon terminologjik nëpërmjet çifteve të mëposhtme, si joterma dhe terma.

Fjalë të përgjithshme si të veçuara ose në përbërje të togfjalëshave	Terma të caktuar si të veçuar ose në përbërje të togfjalëshave
mbyll / hap	Nxehtësi / ftohtësi (fiz)
lidhje / zgjidhje	mall / jomall (ek.)
i (e) lehtë / i (e) rëndë tek: punë e lehtë – punë e rëndë;	i (e) lehtë / i (e) rëndë tek: plug i lehtë / plug i rëndë;
i (e) drejtë / i (e) padrejtë tek: fjalë e drejtë / fjalë e padrejtë.	i (e) madh / i (e) vogël tek: ingranazh i madh / ingranazh i vogël

Në të gjithë shembujt e nënvizuar kemi raste kundërvënie brenda disa kushteve të caktuara, duke supozuar gjithnjë se njësitë antonimike krijojnë kundërvënie nga pikëpamja leksiko-semantike, domethënë ato kundërvihen brenda kuptimeve të caktuara. Pra, këtu ky kusht duhet të shërbejë si bazë, çka do të thotë se janë kuptimet e njësive që kundërvihen e jo baza sendore-konceptore, ndryshe, po të ishte kjo e fundit, atëherë në kundërvënie, sidomos në disa prej tyre, do të kishte shkallëzime, pra mund të vendoseshin elemente të tjera që do ta thyenin kundërvënien, tek disa njësi që kundërvihen si tek e drejtë – e padrejtë – jo e drejtë – e shtrembër.

Tek termat kjo shkelje mund të jetë më e madhe si tek *i lehtë* (*plug i lehtë*), *i rëndë* (*plug i rëndë*), ku *i lehtë / i rëndë* nuk përcaktohet me shumë kundërvënie nga “pesha” sesa nga funksioni. Po kështu “*i madh-i vogël*” tek “*ingranazh i madh*”, “*ingranazh i vogël*”, madhësia është mjaft relative.

¹⁰ M. Samara, *Çështje të antonimisë në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1985.

Ky kusht, sidomos për termat, merr rëndësi thelbësore kur ata vështrohen jo nga ana konceptore, meqë termat si dhe fjalët, shënojnë kuptim, çka i bën ata të trajtohen nga ana kuptimore, pra, si kategori leksiko-gramatikore.

Ky trajtim i termave nga ky këndvështrim përbën një kufizim vështrimi ndaj termave, sepse në vend që të shihen si shprehje konceptesh, vështrohen si shprehje kuptimesh. Vështrimi konceptor i termave për anën antonimike të tyre mund të dalë edhe më e qartë, nëse i referohemi disa termave nga ana thjeshtë konceptore, ku disa prej tyre s'kanë të kundërtën e vet dhe në përbërje të togfjalëshave shfaqen si elemente kontradiktore (paradoksale) në vetvete. Kështu, p.sh., njësitë përcaktuese mbeten të izoluara së bashku me elementin e përcaktuar në togfjalëshat si *vrinë e zezë* (kozm.), *luftë e ftohtë* (*s'ka të nxehtë*), *tradhëti e lartë* (*s'ka të ulët*). Kështu mund të vijohet me *karton i kuq* (sport.)- *ushtri e kuqe- libër i bardhë – çek i bardhë - mish i bardhë* etj.

Po kështu, nga pikëpamja e konceptit që shpreh, si dukuri fizike, koncepti *nxehtësi* përbën shkallë të caktuara, si të thuash, të vetvetës. 95°C, 35°C, 15°C, -1°C, -15°C, janë shkallë të caktuara nxehtësie, ku në përfytyrimin e zakonshëm joshkencor 95°C përbën *nxehtësi*, 35°C *ngrohtësi*, -1°C *ngrirje* (ftohtësi) etj., pra do të kishim kundërvënie *nxehtësi – ftohtësi* me shkallëzime; *vaktësi – freski* etj. Kjo rrethanë bën që qysh në fillim në këndvështrimin e antonimisë ndaj termit duhet të kihet parasysh të dyja anët e tij: si ana leksiko-semantike, domethënë si kuptim i shkëputur nga baza sendore – logjike, pra *i lehtë, i rëndë* (si fjalë tek *i lehtë, i rëndë* të shkëputura nga fjalët e përcaktuara (ashtu si edhe janë studiuar deri tani), por edhe si shprehje konceptesh, por, jo të veçuara, por brenda lidhjes sintaksoro-konceptore, pra si “kundërvënie” konceptesh *plug i lehtë / plug i rëndë* (*bujq.*), *tension i lartë / tension i ulët* (*tek.*). Po kështu kjo veçori mund të shihet tek *trëndafil i butë, trëndafil i egër; trëndafil i bardhë / trëndafil i kuq, mollë e egër / mollë e butë* të cilat dalin edhe si kundërvënie e të gjitha njësisive në nivel togfjalëshash vështruar nga ana konceptore kurse do të kundërviheshin si njësi më vete nga ana leksiko-semantike: *i butë / i egër, i bardhë / i kuq* etj.

Me këtë rast duhet nënvizuar se trajtimi i parë i problemit të antonimisë në terminologji është kryer nga prof. Hëna Pasho¹¹, që mbështetet në këndvështrimin leksiko-semantik, siç është zbatuar edhe në monografinë e prof. Miço Samarës. Megjithatë në punimin e H. Pashos, pasi trajtohen anët e përbashkëta të antonimisë në leksikon e përgjithshëm me leksikon terminologjik, aty nënvizohen edhe vlera të antonimisë si faktor sistemor në terminologji, si saktësim i kuptimit nëpërmjet të kundërtës (kundërvënies) etj. sepse një nga vetitë e antonimisë është asociacioni i një gjymtyre përmes tjetrës, çka siguron kundërvënien si: *natë / ditë, jashtëm / i brendshëm* etj.

¹¹ H. Pasho, *Vështrim mbi disa shfaqje të shumëkuptimisë, të sinonimisë e të antonimisë në terminologjinë e ekonomisë në gjuhën shqipe*, SF, 1986/3.

Në raste të tjera, ku kjo kundërvënie cenohet përmes, më tepër, anës mohuese, atëherë duhen marrë të dy gjymtyrët në bashkëvajtje me gjymtyrën e përcaktuar si të përbashkët si: *ngjyrë e zezë / ngjyrë e kuqe, ngjyrë e zezë / ngjyrë e bardhë* (ngjyrë) ose duhen vështruar fjalët në vetvete: *si mall / jomall, punëtor / jopunëtor*. Kjo vihet re kur këto njësi vështrohen si terma të kundërvënë në rrafshin sendor-konceptor. Po kështu edhe tek *punësi / papunësi*, *i punësuar / i papunësuar, djegie / mosdjegie* etj. Kjo do të thotë se në rastin e termave togfjalësh kundërvënia nga ana konceptore, pra kur kundërvihen konceptet, kundërvëniet i përkasin të dy togfjalëshave që ballafaqohen. Kjo mund të vërtetohet nga sinonimet njëfjalëshe që mund të kenë këto njësi si: *labot i egër = minuer dhe labot i butë, trëndafil i bardhë dhe trëndafil i kuq dhe trëndafil i bardhë = balkroca dhe trëndafil i kuq = kërmiz*¹².

Kjo do të thotë se vlerësimi i disa sendeve nga “pesha”, “përmasa”, “ngjyra” në terminologji është më shumë funksionale, pra i përket përmbajtjes, anës konceptore, prandaj edhe del problemi i kundërvënies konceptologjike (në nivel konceptor) siç e përmendem më lart tek: *plug i lehtë / plug i rëndë, rrotë e madhe / rrotë e vogël* etj. Ky vështrim, d.m.th. konceptor, nuk përjashton rastin kur kundërvënia mund të bëhet edhe nga ana kuptimore, duke marrë të veçuar gjymtyrët përcaktues si të kundërvënë si: *i butë / i egër tek trëndafil i butë / trëndafil i egër*.

Vetëkuptohet se këndvështrimi konceptor është disi kufizues për termat, përderisa termat shprehin si koncepte ashtu edhe kuptim dhe si të tilla kur kundërvihen duhet të shihen kryesisht si kundërvënie konceptesh më shumë se sa kundërvënie kuptimesh. Kjo rrethanë bën qysh në fillim, që në këndvështrimin e antonimisë ndaj termit duhet të mbahen parasysh të dyja anët e tij: ana leksiko semantike, domethënë, si kuptim i shkëputur nga baza sendore konceptore, pra *i lehtë / i rëndë* (si fjalë të shkëputura nga fjalët e përcaktuara (ashtu si edhe siç janë studiuar deri tani), por edhe si shprehje konceptesh, por, jo të veçuara, por brenda lidhjes sintaksoro-konceptore, prasi “kundërvënie” konceptesh si tek *plug i lehtë / plug i rëndë*.

Në përfundim mund të themi që antonimia në njërin këndvështrim ndaj saj është i njëjtë si në leksikon e përgjithshëm, por, e trajtuar në kuadrin e veçorive të saj shprehëse përmbajtësore (konceptore), ka disa anë problematike që duhen studiuar brenda veçorive të saj specifike. Në këtë trajtesë vetëm sa hapëm rrugën për t’a vështruar dukurinë e antonimisë në terminologji, krahas anës kuptimore edhe nga ana e veçorive të saj si dukuri në këtë fushë. Nga ana tjetër, ky këndvështrim hap shtegun për trajtime më të thelluara të këtij problemi në të ardhmen.

¹² Xh. Lloshi, *Fjalori emrave të bimëve dhe të kafshëve (shqip – latinisht, latinisht – shqip)*, Logosa, Shkup, Prishtinë, 2010.